



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:013632
Datë: 26.07.2023
Numri i dokumentit: 04523965

Ka. nr. 288/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik – person juridik “Autogeni Ada Gas Company”, SHPK, me NRB: 810273409, Njësia në rrugën Gllama - Qarkore në Gjilan, me personin përgjegjës Ridvan Murati, me Përfaqësues sipas autorizimit Hajredin Leka, avokat nga Gjilani, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 sanksionuar sipas nenit 19 par. 4 pika 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri përmes Përfaqësuesit sipas autorizimit Hajredin Leka, avokat nga Gjilani, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 55/22, të datës 29.06.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 5, të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si pjesërisht e bazuar ankesa e paraqitur nga i pandehuri përmes Përfaqësuesit sipas autorizimit Hajredin Leka, avokat nga Gjilani, dhe
NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 55/22, i datës 29.06.2023, vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që ndaj të pandehurit Subjektit Ekonomik - Person juridik “Autogeni Ada Gas Company”, SHPK, me NRB: 810273409, Njësia në rrugën Qarkore në Gjilan, me personin përgjegjës Ridvan Murati, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 sanksionuar sipas nenit 19 par. 4 pika 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, **lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2020**, konform nenit 35 të LK-së, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej **5000(pesëmijë)€**, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar e njëjta do të arkëtohet me dhunë sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Gjiilan – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut me Nr. 19/22, të datës 10.01.2022, me numër të protokollit Nr. 45-02, me aktgjykim K. nr. 55/22, të datës 29.06.2023, të pandehurin subjektin ekonomik si person juridik “Autogeni Ada Gas Company”, SHPK, me NRB: 810273409, Njësia në rrugën Qarkore në Gjiilan, me personin përgjegjës Ridvan Murati, me Përfaqësues sipas autorizimit Hajredin Leka, avokat nga Gjiilani, e ka shpall përgjegjës:

- sepse më datë 31.12.2021, Inspektorët e tregut të MINT-së, kanë inspektuar subjektin ekonomik “Autogeni Ada Gas Company”, SHPK, gjatë inspektimit është konstatuar në Procesverbalin e Inspektimit Nr. 19/000018, se ky subjekt ushtron veprimtarin tregtare shitje me shumicë të benzinës dhe Dizellit pa Licencë, i cili nuk ka prezantuar dokumentacionin e cekur kur i është kërkuar nga inspektorët për çka ka qenë i obliguar sipas nenit 4 të Ligjit 2004/05 për tregti me naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, ku thuhet citim “ Asnjë person nuk mund të merret me Import apo shitje të derivateve të naftës brenda kapaciteteve të shitjes me shumicë dhe pakicë, për qëllime afariste pa një Licencë aktuale valide të lëshuar na Zyra e Licencimit”, në ç rast kërkesës i janë bashkangjitur Informatat për Biznes të ARBK-së, Procesverbali Nr.19/ 000018 i datës 31.12.2021, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 dhe 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 4 pika 4.1 të Ligjit Nr. 08/1-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej **10.000(dhjetë mijë)€**, të cilën ka për ti paguar në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa në qoftë se nuk e kryen pagesën në afatin ligjor i njëjti dënim me gjobë do të ekzekutohet me dhunë, sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Me të njëjtin aktgjykim është obliguar i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **10(dhjetë)€**, në afate të njëjta me gjobën.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë i pandehuri “Autogeni Ada Gas Company”, SHPK, Njësia në rrugën Qarkore në Gjiilan, përmes Përfaqësuesit sipas autorizimit Hajredin Leka, avokat nga Gjiilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse neni 139 par.1 nën par. 1.7, 1.8, dhe 1.9 të LK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nga neni 141 të LK-së, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale neni 140 par.1 nën par. 1.2 të LK-së, në të cilën veç të tjerash thekson: faktet vendimtare nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar si duhet për çka është bërë edhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plot i gjendjes faktike dhe është aplikuar gabimisht edhe e drejta materiale. Aktgjykimi nuk përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të kundërvajtjes, secila provë e administruar në seancë gjyqësore së pari duhet të jetë objekt vlerësimi a është konstatuar ekzistimi i veprës kundërvajtëse e më këtë edhe përgjegjësia e të pandehurit për kundërvajtje, e pastaj të kalohet me marrjen e epilogut në çështjen kundërvajtëse por në aktgjykimin e ankimuar nuk shihet se është bërë një vlerësim i tillë nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje nga neni 139 par. 1 nën par. 1.7 të LK-së. Ekziston shkelje nga neni 139 par. 1 nën par. 1.8 të LK-së, e cila shkelje konsiston në faktin se gjykata nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës e kjo si pasojë e vlerësimit jo adekuat të provave të administruara në seancë gjyqësore. Gjykata vendimin e mbështet në prova gjysmake vetën në Fatura duke mos i dhënë rëndësi provave të tjera që kanë rëndësi vendimtare për vendosjen e drejtë të çështjes, provave materiale si kuponëve fiskal, kartelat financiare, flet dërgesat për pranim – dorëzim të sasive të shitura ditore të derivateve të naftës, ndërsa me këto prova bindshëm provohet se subjekti në

fjalë në periudhën kontestuese nuk ka bërë shitje me shumicë të karburanteve në pikën shitëse të tij. Shkelja nga neni 139 par. 1 nën par. 1.9 të LK-së, konsiston në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin pasi që nuk përmban arsye për fakte vendimtare të çështjes, nuk është cekë në bazë të cilës provë është vërtetuar ai fakt dhe cilat fakte gjykata i merr si të vërtetuara, andaj arsyetimi është i pa qartë dhe kontradiktor është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit. Një gjendje e tillë qon në konkludim se aktgjykimi i ankimuar ka dhënë një epilog të gabuar dhe në dëm të subjektit ekonomik. Si rrjedhojë e shkeljeve procedurale gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur ta vërtetoj drejtë gjendjen faktike në këtë çështje kundërvajtëse, andaj kjo është në kundërshtim me nenin 49 të LK-së. Pretendimi i Inspektoratit të Tregut se i pandehuri gjatë viti 2021, ka shit me shumicë karburante pa Licencë është demantuar plotësisht nga i pandehuri me prova konkrete materiale të cilat gjatë gjykimit ia ka prezantuar gjykatës e të cilat ndodhen në shkresë të lëndës. Faturat e prezantuara nga inspektori pasqyrojnë sasinë e karburantit të shitur për një periudhë më të gjatë kohore dhe atë 30 ditore, qoftë personave fizik apo subjekteve ekonomike, gjithnjë në rezervarët e automjeteve të tyre. Pra, sasia e përgjithshme e dizellit dhe benzinës të shitur e të prezantuar në faturat kontestuese tregon se kemi të bëjmë me shitje ditore me pakicë të karburanteve por të përmbledhur dhe të paraqitur në faturë si shitje brenda një periudhe më të gjatë kohore. I pandehuri nuk është has asnjëherë në vendin e ngjarjes nga Inspektorët e Inspektoratit të Tregut, duke shitur me shumicë karburante ai nuk është zënë në flagrancë duke shitur me shumicë dhe nga denoncuesi nuk është prezantuar asnjë foto duke mbushur nga pompa e tij ndonjë cisternë – maunë apo makinë speciale dhe duke e furnizuar me karburant në sasi që trajtohet mbi sasinë e shitjes me pakicë të karburantit. I pandehuri asnjë biznesi e as “Vullkani”, dhe “Dani Company”, SHPK nuk i ka shitur sasi karburanti më tepër se 200 litra për një ditë dhe për një shitje dhe pas shitjes ai nuk mund të mbanë përgjegjësi për destinacionin e fundit të derivatit të shitur sepse kjo është e drejtë dhe përgjegjësi që pas shitjes i kalohet blerësit. Andaj nga të cekurat nuk është provuar se në veprimet e të pandehurit janë manifestuar elementet e veprës kundërvajtëse nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 dhe 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 4 pika 4.1 të Ligjit Nr. 08/l-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme.

I propozon Gjykatës se Apelit - Divizioni i Kundërvajtës, që ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e goditur ta Ndryshoj në kuptim të aprovimit të ankesës dhe pezullimit të procedurës kundërvajtëse ose ta Anuloj dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, duke i vlerësuar thëniet në ankesën e paraqitur nga ushtruesi i Kërkesës, aktgjykimin e goditur, si dhe shkresat tjera të lëndës konstatoi se ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar andaj edhe pjesërisht aprovohet.

Gjykata e shkallës së parë, pas anulimit të aktgjykimit K. nr. 55/22 të datës 18.01.2023, në Procesverbal të datës 12.06.2023, është dëgjuar Përfaqësuesi me autorizim Avokati Hajredin Leka, i cili e ka kontestuar në tërësi Kërkesë duke konsideruar se i pandehuri nuk e ka kryer kundërvajtjen e cila me Kërkesë i vihet në barrë, konsideron se Inspektorati i Tregut gabim e ka interpretuar sasinë e derivateve të shitura dhe të prezantuara në Faturat e të pandehurit duke e trajtuar sasinë e shitur dhe të paraqitur në faturë si shitje njëj ditore dhe si shitje me shumicë, ndërsa në rastin konkret bëhet fjalë për shitje për një periudhë më të gjatë kohore (një mujore) dhe sasi me pakicë ashtu si që e parasheh ligji, për vërtetimin e drejtë dhe të plot të gjendjes faktike ka ftuar Ushtruesin e Kërkesës - Fexhrije Salihun, Inspektore e MINT-së, e cila u dëgjua në Procesverbal të datës 14.06.2023, në cilësi të dëshmitares, e cila ka deklaruar se ky subjekt afaristë ka prezantuar Librin e shitjes, ku janë përfshirë edhe disa Pompa - Pika të shitjes me pakicë, të cilat janë furnizuar nga Operatori Ekonomik si për shembull Operatori ekonomik

“Vullkani” SHPK, është furnizuar më datë 31.08.2021 me dizel në sasi prej 1.064 litra, me produktin – benzinë 495 litra dhe disa raste të tjera të cilat konsiderohen si shitje me shumicë sipas Librit të shitjeve të operatorit në fjalë, në Vazhdim të seancës në Procesverbalin e datës 26.06.2023, është bërë ballafaqimi në mes të Përfaqësuesit me autorizim avokatit Hajredin Leka, në prezencë të personit përgjegjës në subjektin afarist Ridvan Muratit, si dhe ushtruesit të kërkesë tani Elijesa Beqiri, e cila ka sqaruar deri në detale shitjen me shumicë të operatorit në fjalë të dizellit dhe benzinës dhe se i njëjti operator edhe sipas ligjit dhe UA-vë, mban përgjegjësi për shitjen me shumicë pasi që i njëjti nuk është pajisur me Licencë për shitje me shumicë, personi përgjegjës në subjektin juridik Ridvan Murati, ka deklaruar se ai e konsideron shitjen me shumicë kur e furnizon me kamion – cistern, e i cili Vullkani “Shpk, në pikën e tyre është furnizuar vet, ushtruesi i kërkesë ka mbet në tersi pran Kërkesës së ushtruar, në bazë të kartelave financiare të cilave iu janë bashkangjitur librat afaristë të subjektit në fjalë – Pasqyra financiare e qarkullimit të derivateve ndaj bizneseve, dy notesë të Fletë dërgesave, të cilat i ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar avokati Hajredin Leka, në bazë të faturës nr. 1943 të datës 31.08.2021, kuponit fiskal dhe kartelës financiare, në bazë të faturës 21-SHV01-001-1943, ku blerësi është “Vullkani SHPK, Kopjet e Kuponëve fiskal të “Autogeni Ada Gas Company”, SHPK, nr. 600098372, etj, Fotografia e bërë ku shihet qartë në kamion rezervari prej 1000 litrave i subjektit ekonomik “Vullkani” Shpk, **Leja për Trageti me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme Nr. 118 e vlefshme prej 06.06.2022 – 05.06.2028, shitje me shumicë të dizellit dhe benzinës,** si dhe nga shkresat tjera të lëndës, pa dyshim se gjykata e shkallës së parë, e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 dhe 2.3 sanksionuar sipas nenit 19 par. 4 pika 4.1 të Ligjit Nr. 08/l-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, andaj në këtë drejtim nuk ka bazë për ndryshimin apo anulimin e aktgjykimit të goditur.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, pasi që Kolegji aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe në këtë aspekt gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje nga neni 139 par. 1 nën par. 1.7 të LK-së, nga neni 139 par. 1 nën par. 1.8 dhe 1.9 të LK-së, e të cilat detyrimisht do ta kishim kushtëzuar prishjen e aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit material

Kolegji vlerëson se me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji material, siç pretendon Përfaqësuesit me autorizim avokatit Hajredin Leka, kjo për faktin se veprimet e të pandehurit përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës kundërvajtëse nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.2 sanksionuar sipas nenit 19 par. 4 pika 4.1 të Ligjit Nr. 08/l-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, posaçërisht kjo vërtetohet nga fotoja e cila është në shkresa të lëndës ku shihet një Rezervar prej 1000 litrave, për të cilin inspektorët kanë konstatuar se është i subjektit afarist “Vullkani” Shpk, çka konsiderohet shitje me shumicë, pra gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Kolegji, konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike është i qartë, konkret, përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje kundërvajtëse dhe në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar e ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar si dhe ka dhënë arsyet e qarta për vërtetimin e tillë të fakteve

Edhe pse mbrojtja nuk e cek si bazë ankimore vendim mbi dënim, në fakt nuk i referohet fare kësaj baze, megjithatë kjo gjykatë të njëjtin aktgjykim e shqyrtoj sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësues dhe rënduese konform dispozitës së nenit 35 të LK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, megjithatë Kolegji e NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur, vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që të pandehurit Subjektit Ekonomik – person juridik “Autogeni Ada Gas Company”, SHPK, Njësia në rrugën Gllama - Qarkore në Gjilan, për kundërvajtjen e ri - cilësuar sipas nenit 5 të LK-së, (Ligji më i favorshëm), konform nenit 35 të LK-së, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej **5000(pesëmijë)€**, duke ia ulur gjobën e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë se të pandehurit, peshën, rrezikshmërinë, pasojat e veprës së kryer, posaçërisht duke pas parasysh se i njëjti prej datës 06.06.2022 është pajisur me **Leje për Tragetit shitje me shumicë të dizellit dhe benzinës të produkteve të naftës dhe karburante të ripërtrishme Nr. 118 e vlefshme prej 06.06.2022 – 05.06.2028**, duke konsideruar se edhe me gjobën e shqiptuar tani do të arrihet qëllimi i ndëshkimit, pasi që qëllimi është përmisimi i të pandehurit e jo ndëshkimi i tij, dhe se i njëjti subjekt tani më nuk e përsërit kundërvajtjen e njëjtë.

Në vështrim të nenit 143 par. 1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka. nr.288/2023, me datë 19.07.2023,



KRYETARJA E KOLEGJIT,
Azra Cakolli